

Nr. 1905 Prot.

Tiranë, më 05.11.2025

Nr. 210 Prot.,

Tiranë, më 05.11.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MIDIS

UNIVERSITETIT TË ARTEVE

DHE

QENDRËS MULTIFUNKSIONALE "NEW GENERATION"

Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet midis:

Universitetit të Arteve Tiranë, institucion publik i arsimit të lartë, i themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me VKM nr. 234, datë 23.03.2011, me seli në adresën: Sheshi "Nënë Tereza", nr. 2, Tiranë, 1019, i përfaqësuar nga Rektori Prof. Dr. Erald Bakalli, (në vijim referuar si "UNIVERSITETI"), dhe

Qendrës Multifunksionale "New Generation" (në vijim referuar si "QMNG"), institucion arsimor privat që ushtron veprimtarinë e vet në Republikën e Shqipërisë, licencuar sipas VKM 798, datë 22.07.2009 dhe akredituar sipas Vendimit Nr. 9, datë 17.02.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

UNIVERSITETI dhe QMNG do të quhen palë të kësaj Marrëveshje.

Duke synuar promovimin e veprimtarive me interes të përbashkët, Palët e kësaj Marrëveshje bien dakord të bashkëpunojnë për termat e mëposhtëm:

1. UNIVERSITETI dhe QMNG bashkëpunojnë në fushat me interes të përbashkët, në interes të promovimit të proceseve akademike dhe profesionale.
2. Palët bien dakord që të shkëmbejnë eksperiencë dhe burime njerëzore (studentë/pedagogë), të cilat i shërbejnë të dyja palëve së bashku, brenda kuadrit të reciprocitetit.
3. QMNG do të angazhohet për angazhimin e studentëve të saj për realizimin e praktikave profesionale të fushës së estetikës dhe kozmetologjisë në rastet e vënies në skenë të performancave skenike të organizuara nga UNIVERSITETI, në të cilat studentët e QMNG do të realizojnë:

- ✓ grimin e performuesve (studentë/pedagogë) të UNIVERSITETIT, apo të ftuar në performanca;



- ✓ prerje, krehje dhe stilim flokësh të tyre;
 - ✓ trajtime të ndryshme për karakterin e figurave;
 - ✓ trajtime estetike në kuadër të spektakleve.
4. UNIVERSITETI do të shqyrtojë mundësitë për zhvillimin e ndonjë moduli/lënde ekstrakurrikulare, që do të shërbejë për të rritur aftësitë artistike të studentëve të UNIVERSITETIT dhe QMNG, që mund të shërbejë për zhvillimin e hapësirave të tyre të punësimit;
 5. Palët në këtë Marrëveshje do të shkëmbejnë informacion lidhur me çështje që përbëjnë interes reciprok, në mënyrë të vazhdueshme, duke përcaktuar edhe strukturat përgjegjëse përkatëse për shkëmbimin e informacionit.
 6. Palët bien dakord që për veprimtari apo projekte të përbashkëta, do të caktojnë secila personat përgjegjës, të cilët do të ndjekin marrëdhëniet konkrete si dhe do të zgjidhin çështjet me karakter teknik për rastet në fjalë.

Personat përgjegjës për Palët:

Për UNIVERSITETIN:

Person kontakti: Z. Ened Kuka
E-mail: enkuka@live.com

Për QMNG:

Luna Vangjeli ilirtefy@gmail.com

7. Palët angazhohen të përmirësojnë në mënyrë të vazhdueshme këtë Marrëveshje Bashkëpunimi dhe bien dakord për pasqyrimin e tyre në një dokument të shkruar, sa herë që kjo paraqitet e nevojshme.
8. Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e nënshkrimit të saj, me të drejtë ripërtëritje. Me kalimin e 10 (dhjetë) ditëve nga data e përfundimit të afatit të marrëveshjes, nëse palët nuk shprehen ndryshe me shkrim, marrëveshja konsiderohet e rinovuar.
9. Secila nga palët, kur e sheh të arsyeshme, mund të kërkojë zgjidhjen e kësaj Marrëveshjeje, duke njoftuar menjëherë me shkrim Palën tjetër për këtë vendim.

Kjo marrëveshje është formuluar në 2 (dy) kopje origjinale, identike, dhe është nënshkruar me vullnet të plotë dhe të lirë nga palët, pasi u lexua, u kuptua dhe u pranua prej tyre.

UNIVERSITETI I ARTETVE

REKTORI

PROF. DR. ERALD BAKALLI

QENDRA MULTIFUNKSIONALE
"NEW GENERATION"

ADMINISTRATORI

ILIR TAFAJ